

KONTRATA E NEGOCIUAR

Datë: 23.01.2019

PJESA I E KONTRATËS

KOMUNA E PRISHTINËS, rruga UÇK-së nr.2 (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;
Dhe

"Niti - N" nga Prishtina, adresa: "Lidhja e Prizrenit", me numër të regjistrimit të biznesit 71064727 dhe me numër fiskal 601122716 e përfaqësuar nga Naim Zymeri – drejtor, në tekstin e mëtejme ("Ofruesi i shërbimeve"), janë pajtuar për realizimin e shërbimeve si në vijim:

Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve të qytetit ,debllokimi i kanalizimit atmosferik - LOT 6

Numri i prokurimit: 616 19 004 215

Neni 1

Lënda 1.1 Lënda e kësaj kontrate është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen shërbimeve dhe punëve të mirëmbajtjes në vijim: **Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve të qytetit ,debllokimi i kanalizimit atmosferik - LOT 6 sipas** specifikimeve teknike detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Kontraktori, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të përfornohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative dhe NUK detyrojnë Autoritetin Kontraktues të blejë ndonjërin prej tyre. Autoriteti Kontraktues me të drejtë të tij mund të porosisë shërbime më pak ose më shumë sasi se sa ato sasi të vlerësuara për artikull p.sh brenda një pjese (loti) të njëjtë. Megjithatë, Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje sa herë që të prokurojnë punë; të përmendura në 1.1.

1.4 Ofruesi i shërbimeve NUK do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do të lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktues vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parapara të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktues vendos të MOS blejë ASNJË nga këto sasira për disa artikuj.

1.5 Kontrata hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit të kontratës dhe përfundon në një periudhë prej 4 muajsh.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë nga data 23.01.2019 deri me datën 15.05.2019 prej 4 muajëve.

2.2 Vendi i kryerjes se shërbimeve do të jetë në Prishtinë: në rrugët dhe trotuaret e cekura për pjesën e dytë në Aneksin 1.

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimi i shërbimeve për mirëmbajtje për tërë sezonën shërbimet per periudhën kontraktuese janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Kontraktuesi. Çmimi total i shërbimeve është: **61.455,65€; (gjashtë dhjetë e nje mije e katër qind e pese dhjete e pese euro e gjashte dhjete e pese eurocent)**.
- 3.2 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës. Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën për çdo muaj në bazë të punëve dhe shërbimeve të kryera sipas raportit të Menaxherit/menaxherëve të projektit nga Komuna. Çdo pagesë duhet te aprovohet nga Zyrtari i prokurimit dhe zyrtari i financave te Autoritetit Kontraktues.
- 3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të shërbimeve sipas kontratës se negociuar.
- 3.3 Çmimet e njësisve do të jenë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë te negociuar.
- 3.4 Pagesat do te jene mujore.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata e negociuar
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.



5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqimi, miratimi, certifikata apo vendimi do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 ZKA me nënshkrimin e kësaj kontrate merr përgjegjësinë për sigurimin e mjeteve për pagesë, ndërsa për shqyrtimin e ofertave dhe zgjedhjen e kontraktuesit bazohet në vlerësimin e komisionit


profesional, të cilët janë përgjegjës për vlerësimin e kriterëve të përzgjedhjes dhe përmbajtjen e ofertave të operatorëve ekonomik.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën Shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin
Zekë Bardhaj	Emri:	<i>Haim Zimeri</i>
Udhëheqës i Prokurimit	Pozita:	<i>DREKTOR</i>
<i>[Signature]</i>	Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>
<i>23.04.2019</i>	Data:	<i>23.04.2019</i>
	Vula:	



Pjesa e gjashtë (Lloto VI)				
<p>Largimi i borës dhe akullit nga rrugët dhe trotuaret sipas pozicioneve të parapara në specifikimin e aktiviteteve</p> <p>a) Largimi i borës nga rruga; b) Largimi i borës nga trotuari; c) Hedhja e kripës të kombinuar me rërë; d) Hedhja e rërës; h) Mbledhja e mbeturinave nga shportat dhe pastrimi i shportave;</p> <p>Vërejtje: në këtë pozicion duhet të jepet çmimi për të gjitha aktivitetet e parapara sipas specifikimit të aktiviteteve për mirëmbajtjen e një metri katror të rrugës ose trotuarit në ditët kur kemi reshje të borës</p>	m ²	292,880 (m ²) x16(ditë) = 4,686,080.00	0.0011	5,154.69€
<p>Mbledhja e mbeturinave, fshirja dhe larja e rrugëve sipas pozicioneve të parapara në specifikimin e aktiviteteve</p> <p>e) Mbledhja e mbeturinave dhe fshirja e rrugëve; f) Larja e rrugëve; g) Pastrimi dhe deblokimi i kanalizimit atmosferik; h) Mbledhja e mbeturinave nga shportat dhe pastrimi i shportave;</p> <p>Vërejtje: në këtë pozicion duhet të jepet çmimi për të gjitha aktivitetet e parapara sipas specifikimit të aktiviteteve për mirëmbajtjen e një metri katror të rrugës ose trotuarit në ditët kur nuk kemi reshje të borës</p>	m ²	292,880 (m ²) x95(ditë) = 27,823,600.00	0.0011	30,605.96€
Furnizimi, transportimi, matja para organit mbikëqyrës dhe deponimi i kripës.	ton	207	115	23,805.00€
Furnizimi, transportimi dhe deponimi i rërës.	m ³	126	15	1,890.00€
Totali për pjesën e gjashtë:				61,455.65€

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	"NITI-N" SH.P.K
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	NAIM ZYMERI
NËNSHKRIMI:	
DATA:	22/01/2019
VULA:	